



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Sudski Savet Kosova/Kosovo Judicial Council

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NË MES TË:

Ministrisë së Drejtësisë, të cilën e përfaqëson Prof. Dr. Hajredin KUÇI, Zëvendëskryeministër dhe
Ministër i Ministrisë së Drejtësisë,

dhe

Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të cilën e përfaqëson z. Enver PEÇI, Kryesues i Këshillit Gjyqësor të
Kosovës.

I

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje bashkëpunimi në pajtim me nenin 94 paragrafi 4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082, pajtohen që të bëhet bartja e kompetencave dhe kalimin e Panelit për lirim me kusht nga Ministria e Drejtësisë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

II

Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, formojnë Komisionin e përbashkët për pranimit dorëzimin e aseteve dhe dokumenteve në përdorim nga Paneli për lirim me Kusht.

III

Ministria e Drejtësisë pajtohet që Koordinatorin e Panelit për Lirim me Kusht si dhe gjitha asetet, inventari, arkiva, dhe pajisjet tjera me të cilat disponon Paneli për Lirim me Kusht, të kalojnë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Pagesa e koordinatorit të Panelit për Lirim me Kusht, do të vazhdojë të bëhet nga Ministria e Drejtësisë deri në rishikimin e buxhetit të vitit 2013.

IV

Procesverbali i përpiluar nga Komisioni për pranim dorëzimin e aseteve dhe dokumenteve në përdorim nga Paneli për lirim me Kusht, do ti bashkëngjitet kësaj marrëveshje.

V

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet në katër (4) kopje, dhe secila palë nënshkruese merr nga dy (2) kopje të nënshkruara.

VI

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Prof. Dr. Hajredin Kuçi,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Ministrisë së Drejtësisë



Enver Peci
Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor



Prishtinë me datë ____/____/2013